

Nr. regj. 18227/2012

DPK/DMP	03-2726/1
02	02-08-2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me procesmbajtësen Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Ferki(Latif)Fejza, nga Kçiçi i Madh, Komuna e Mitrovicës, për kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 25.07.2012 morri këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI: Ferki(Latif)Fejza**, i lindur më 01.02.1974 në Mitrovicë, ku dhe jeton, ekonomist, ka të kryer Fakultetin e Fizikës, kryeshef i Agjencisë për mbrojtje të rrezatimit dhe Sigurisë bërthamore në Kosovë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike,

### **Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse si zyrtarë i lartë publik, kryeshef i Agjencisë për mbrojtje të rrezatimit dhe Sigurisë bërthamore në Kosovë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31 mars 2012, në Agjencinë kundër korrupsion, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, andaj i shqiptohet

## **D Ë N I M**

**Me gjobë në shumë prej 2000(dymijë)€, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh,** pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Paga bëhet në ndonjë agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30(tridhjetë) ditësh.** Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga **5 €**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

## **A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë**, i parashtror kësaj gjykate kërkesën nr. 01-1830/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se ka bërë deklarinim me marrjen e detyrës së kryesheft të Agjencisë për mbrojtje të rrezatimit dhe Sigurisë bërthamore në Kosovë, poashtu ka marr aplikacionin për deklarinim vjetorë, por për shkak të ngarkesës në punë, i është përzier formulari me dokumentacionin tjetër zyrtarë kështu që ka harru se duhet me e bërë deklarinim ligjor deri më 31. mars, deklaroi se një kohë relativisht të gjatë ka qenë në udhëtim zyrtarë andaj, nuk ka qenë prezentë në Kosovë. Gjykatës ia prezanton Vërtetimin me nr. Protokollit 03/3508 të datës 05.06.2012, se ka deklaruar pasurinë.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin të deklaratës së të pandehurit, vlerësimin të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë pasi që më afatin e paraparë ligjor deri 31.03 2012 nuk ka bërë deklarinim e pasurisë. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, andaj i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
Nr. Regj. 18227/2012, më datë 25.07.2012

Gjyqtaria  
Azra Cakolli

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimin të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.